



**Spanja**  
Zgjedhjet dhe ndryshimi pas Zapateros

NE FAQET 14-15



**Itali**  
Kush ka votuar për ju zoti Monti?

NE FAQET 18-19



**Eksperimenti**  
Neutrino, sërish fitimtar kundër Ajnshtajnit

NE FAQEN 20



# Shqip



Adresa e redaksisë: Rr. Sami Frashëri,  
Pallatet e Aviacionit, Nr. 4  
Tel: 04 2 272 565 • 069 20 35 300  
066 20 35 300  
E-mail: info@gazeta-shqip.com

Drejtor **BESNIK MYFTARI**  
Kryeredaktor **ALEKSANDËR ÇIPA**

Viti VI - Nr. 316 (2048) Eshtunë 19 nëntor 2011 E përditshme e pavarur Çmimi 50 lekë, 1.5 euro

www.gazeta-shqip.com

Nis diskutimi i vrullshëm. Luan Rama i LSI-së: Bashkëpunimi nuk është i pamundur. Edi ka në dorë shanset që lidhen me Edin. Braçe revoltohet

## Afrimi PS-LSI, të majtët ndezin sherrin

Debate të ashpra në kryesinë e grupit. Rama sulmon deputetët që dolën nga rreshti

“Jemi bërë parti e fshatit”  
**Stringa: Aleanca me LSI-në e ka dëmtuar PD-në**

Omer Striga, dekan i Fakultetit Ekonomik dhe ish-anëtar i Kryesisë së Partisë Demokratike, flet në një intervistë për “Shqip” mbi politikën e ditës dhe debatet e fundit mbi ekonominë...

NE FAQEN 4



NE FAQET 2-3

Dosja e plotë e akuzës për 9 punonjësit e METE-s. Gjykata i lë në burg Përgjimet e prokurorisë, sekserët dhe gjobëvënësit e Metrologjisë

Prokuroria e Tiranës ka zbardhur skemën e funksionimit të punonjësve të Drejtorisë së Metrologjisë të arrestuar dy ditë më parë gjatë operacionit “Kalibrimi”. Përgjimet 15-ditore me urdhër të gjykatës, nga data 12-27 shtator, kanë zbuluar emrat e zyrtarëve të implikuar që merrnin rryshfet në këmbim të lejitimit të parregullsive të peshoreve të ushqimeve dhe të karburantit. Prokurorët Sotir Kllapi...

NE FAQET 24-25

**TË MBASH GOJËN**

SKËNDER MINXHOZI

Pak ditë më parë Ben Blushi shprehej në një intervistë për Alfred Pezën, se Kryeministri Berisha është një njeri banal. Si gazetar dhe politikan, ai, bashkë me shumë të tjerë, e kanë ndjekur kurbën politike të kreut të qeverisë në dy dekada. Nga dekada...

NE FAQEN 8

“META...STAZAT” E GJYKATËS THONË: JU KANË BËRË SYTË

ANDREA STEFANI

Mënyra se si një gjykatë po e trajton skandalin e videos Meta-Prifti është edhe një provë më shumë...

NE FAQEN 9

Kryesocialisti, mbledhje me dyer të mbyllura me asamblenë lokale dhe deputetë  
**Qarku i Fierit, dhjetëra policë e militantë në selinë e trazuar**



Këshilli i Qarkut të Fierit po sjellë çdo ditë nga një zhvillim të ri. Pasditën e djeshme rreth orës 15:00, në ambientet e Këshillit të Qarkut të Fierit kanë mësyre me dhjetëra punonjës të Policisë së Shtetit. Ata kanë zaptuar...

NE FAQEN 6

**FUNDI I EPOKËS SË POLITIKANËVE**

BLEDAR KURTI

Ditët e fundit, dy partitë kryesore në vend, PD dhe PS, duket se më në fund kanë nisur bashkëpunimin. Marrëveshja e arritur midis këtyre dy partive u arrit...

NE FAQEN 9

### Nju Xhersi

Mbahet në SHBA konferencë shkencore e nivelit të lartë për çështjen çame

## Muhedini: Zgjidhje ligjore për çamët

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga Organizata Shqiptaro-Amerikane ‘Çamëria’ dhe Instituti i të Drejtave të Njeriut, u organizua në ‘Kean University’, një konferencë për çështjen çame. Në këtë konferencë të parë të këtij lloji mori pjesë edhe presidenti i Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet, Tahir Muhedini, i cili referoi mbi çështjen çame dhe mundësitë e zgjidhjes së saj. Në aktivitetin e organizuar në ‘Kean University’ referoi edhe historiani i njohur...

NE FAQEN 5



Njëri nga banditët mbeti i plagosur. Policia kërkon dy të tjerët

**Shkodër, fermeri bën luftë me tre hajdutë, shpëton 80 krerë dhen**

NE FAQEN 12

### “Occurrence on Earth”



**Preç Zogaj, dy orë poezi shqipe në SHBA**

NE FAQEN 28

### Histori-Filologjia

Ministria e Financave nuk paguan profesorët për orët shtesë

**Pedagogët bojkotojnë mësimin sot dhe nesër**

NE FAQEN 22



Dhurata më e bukur është tek aftësia e imagjinatës

Përurohet sot në Prishtinë portali i përbashkët elektronik mes Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Gjithashtu në Konferencën Kombëtare të Bibliotekonomisë do të prezantohet edhe portali albanologjik Shqipëri-Kosovë



# Biblioteka e Shqipërisë dhe Kosovës, portal të përbashkët elektronik

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, në bashkëpunim me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë, organizojnë për herë të gjashtë Konferencën Kombëtare të Bibliotekonomisë. Sipas njoftimeve nga mediat kosovare, konferenca është hapur dje në ambientet e BKUK-së në Prishtinë dhe vazhdon punimet edhe ditën e sotme. Një çështje e rëndësishme e kësaj konference dypalëshe ishte bashkëpunimi i ndërsjellë i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë, të cilat sot përurojnë edhe linkun e përbashkët elektronik. I pranishëm në Konferencën Kombëtare të Bibliotekonomisë ishte ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ramë Buja. Ministri Buja me këtë rast ka vlerësuar lart bashkëpunimin mes dy bibliotekave, si dhe ka uruar hapjen e portalit të përbashkët elektronik. "Uroj veçanërisht hapjen e portalit të dy bibliotekave tona të mëdha, të bashkëpunimit asnjëherë dhe natyrisht tashmë të lidhura edhe me një link të veçantë elektronik, portalit të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhe asaj të Shqipërisë", ka thënë ministri Buja. Ndërsa drejtori i BKUK-së, Sali Bashota, ka theksuar se pasurimi i koleksioneve bibliotekare dhe zhvillimi i tyre përmes portaleve më të fuqishme të informacionit global botëror është nismë e bibliotekave kombëtare drejt universalitetit të kulturës kombëtare në integrimet botërore të shekullit 21. Në këtë konferencë dyditore do të bëhet edhe përurimi i portalit albanologjik Shqipëri-Kosovë, i cili konsiderohet ndër projektet më të rëndësishme për kulturën shqiptare dhe proceseve të dixhitalizimit dhe afirmimit të vlerave kombëtare. "Perspektiva kombëtare në integrimet botërore" është tema kryesore mbi të cilën është diskutuar gjatë Konferencës Kombëtare të Bibliotekonomisë. Do të flitet rreth rolit dhe rëndësisë së bibliotekave në sferën e integritetit të përbashkët kulturor, që janë të rëndësishme dhe shumë domethënëse edhe për kulturën e vendit tonë. Veçanërisht e këtij edicioni të gjashtë është se në të do të ketë kumtesa dhe referime nga fusha e informacionit bibliotekar, procesit të dixhitalizimit të librit dhe

perspektivës së tij për kulturën dhe bibliotekonominë në Kosovë. Gjithashtu, në këtë edicion do të bëhet prezantimi i portalit albanologjik, i cili është një projekt i rëndësishëm i integritetit dhe bashkëpunimit ndërmjet Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës (BKUK) dhe Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë (BKSH). Ky portal do të ketë



një vlerë integruese brendakombëtare Kosovë-Shqipëri, ngaqë në të do të jenë të pranishme informacionet themelore rreth librit dhe kulturës sonë kombëtare. Por ai do të jetë i rëndësishëm edhe në planin e integritetit botëror dhe globale, pasi synohet që ai të jetë një portë e rëndësishme e kulturës dhe librit shqiptar. Edicioni i gjashtë i Konferencës Kombëtare të Bibliotekonomisë do të jetë i

ndarë në tri seanca, ku me kumtesat e tyre do të paraqiten njohës të zhvillimeve në fushën e bibliotekarisë, si në Kosovë, edhe në Shqipëri: Etleva Domi, Fazli Gajraku, Ramazan Vozga, Bukurije Haliti, Behije Luga, Enilda Kola, Izet Abdyl, Ramize Bajraktari, Ramush Zekaj, Liridon Zekaj, Mimoza Shkodrani dhe Ederina Demo. Portali i përbashkët

## PROJEKTI

Në këtë konferencë dyditore do të bëhet edhe përurimi i portalit albanologjik Shqipëri-Kosovë, i cili konsiderohet ndër projektet më të rëndësishme për kulturën shqiptare dhe proceseve të dixhitalizimit dhe afirmimit të vlerave kombëtare

elektronik i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë me Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, përurohet pak kohë pasi Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë u bë pjesë e bibliotekës botërore të dixhitalizuar, një proces që do të prezantojë vlerat e trashëgimisë sonë kulturore kudo nëpër botë, duke e bërë atë pjesë të trashëgimisë kulturore botërore.


## "Miss dhe Mister Tirana 2011"

### Tashmë edhe me performanca koreografike

Më datë 12 nëntor, në sallën e Teatrit Kombëtar të Operës dhe Baletit, organizohet edicioni i dymbëdhjetë i konkursit të bukurisë kryeqytetase "Miss dhe Mister Tirana 2011". Në këtë event do të marrin pjesë 20 vajza dhe 17 djem, të cilët nuk do të bëjnë jurinë për vete thjesht me paraqitjen e tyre, por edhe me performancat koreografike, dhe sfilatat me kostume popullore shqiptare. Kjo u bë e ditur nga producenti i këtij spektakli, Alban Karabashi, në një konferencë për shtyp. Do të ketë mjaft çmime në këtë spektakël si "Miss & Mister Ekranit", "Miss & Mister Miqësia", "Miss & Mister Eleganca", "Miss & Mister Kinemaja", "Miss & Mister Buzëqeshja", "Miss & Mister Inteligjenca" etj., për të shkuar te çmimet e mëdha si "Princesha e Tiranës" dhe "Mbretëresha e Kryeqytetit" Mister Tirana 2011.



## Konferenca



## Dy orë poezi shqipe në SHBA

Prezantohet përmbledhja poetike "Occurrence on Earth" (Ngjarje në tokë) e Preç Zogaj, në përkthimin e Gjekë Marinajt. Në konferencën e përvitshme të Lidhjes Amerikane të Përkthyesve të Letërsisë (American Literary Translators Association-ALTA), mbajtur në Kansas City, Missouri, nga data 16-20 nëntor, në programin e leximeve dygjuhëshe të letërsisë bashkëkohore botërore, iu kushtua një vend i rëndësishëm edhe poezisë shqipe. Në fokus të kësaj ngjarjeje, e para e këtij lloji, ishte paraqitja e vëllimit me poezi të zgjedhura të poetit Preç Zogaj "Occurrence on Earth" (Ngjarje në tokë), përkthyer në anglisht nga poeti dhe studiuesi Gjekë Marinaj, kandidat për PhD (Doktor në Filozofi), dhe botuar nga shtëpia botuese e Universitetit të Dallasit në Teksas, "Mondus Artium Press". Fjalën e hapjes e mbajti drejtori i Qendrës së Studimeve të Përkthimeve të Universitetit të Dallasit, dr. Rainer Schulte, PhD, njëherësh poet shumë i njohur amerikan. "Është rëndësishme, theksoi ai, që ALTA ka sjellë një nga letërsitë më pak të njohura nëpërmjet një poeti si Preç Zogaj, libri i të cilit "Occurrence on Earth", na tregon se poezia shqipe është në një stad aq të lartë sa poezia e vendeve më të zhvilluara. Atë nuk do ta njihim si të tillë pa përkthimin shumë cilësor të kolegut tonë, pedagogut të letërsisë bashkëkohore botërore pranë Richland College, Gjekë Marinaj". Në fjalën e tij prezantuese, Marinaj, pasi falënderoi drejtuesit e ALTA-s për përfshirjen e letërsisë shqipe në këtë eveniment letrar kaq të rëndësishëm në shkallë botërore, tha se Preç Zogaj është njëri nga poetët më të dashur të Shqipërisë, poezia e të cilit shquhet për bukurinë, sinjoretin dhe pasurinë emocionale të vizionit të tij poetik. "Ndaj, ngaqë është gati e pamundur t'i parashtrij të gjitha arrijet e tij si poet dhe intelektual i angazhuar në politikë, do të kufizohem vetëm në disa fakte që kanë të bëjnë me jetën dhe veprimtarinë e tij letrare", nënvizoi Marinaj, duke vijuar më pas me dhënien e një informacioni kronologjik të inventarit autorial të Zogaj. Jim Hoggard, aktor i njohur i Teatrit Publik të Dallasit, recitoi trembëdhjetë poezi të Zogajit në anglisht, alternuar me leximin në shqip të katër poezive nga vetë autori i tyre. Hoggard tha se ALTA më kishte dërguar trembëdhjetë poezi, prej të cilave duhej të zgjidhja dhjetë për të recituar, por e gjeta të pamundur të eliminoja ndonjërin prej tyre, ndaj do t'i lexoj të gjitha. Pas leximit të poezive, të pranishmit, midis tyre profesorë të Universiteteve të ndryshme amerikane dhe botërore, i drejtuan pyetjet poetit Zogaj dhe përkthyesit Marinaj në lidhje me poezinë dhe marrëdhëniet e tyre gjatë procesit të përkthimit. Një nga gazetarët e pranishëm, pasi shprehu habinë e tij se si një poezi e një gjuhe të huaj ka ardhur kaq natyrisht në anglisht sa të mos duket si poezi e përkthyer, pyeti nëse poezia e Zogajit është një standard apo një përjashtim në poezinë e Shqipërisë. Zogaj u përgjigj se poezia e tij nuk përbënte as standard, as përjashtim në poezinë bashkëkohore shqipe. "Unë, vazhdoj ai, kam një individualitet timin, të cilin ma ka njohur publiku dhe kritika në vendin tim, por Shqipëria ka plot poetë të shkëlqyer, të cilët besoj se do ta frymëzojnë përkthyesin Marinaj për t'i sjellë në anglisht për gjithë lexuesin anglishtfolës në të ardhmen". Paraqitja dhe leximi i poezive të Zogajit në konferencën e ALTA-s do t'u shpërndahet sipas programit të konferencës universiteteve amerikane dhe së shpejti do të publikohet prej saj në "YouTube".

**Në fokus të kësaj ngjarjeje, e para e këtij lloji, ishte paraqitja e vëllimit me poezi të zgjedhura të poetit Preç Zogaj "Occurrence on Earth"**